REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 628/10 prot. Tiranë, më 04.09.2026

V E N D I M

Nr. 34, datë 04.09.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Ankuesi, z. , gazetar pranë "BIRN Albania" (në vijim "ankuesi"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 628 prot., datë 26.02.2026, vijuar me nr. 628/9 prot., datë 24.06.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Agjencia e Zhvillimit të Territorit" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 30.01.2026, depozituar në adresën elektronike *info@azht.gov.al*, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Mbledhja e KKTU – e premte, 18.04.2025, ora 10:30 - 12:30*
   Pika 12. Leje Zhvillimi për objektin "Resort turistik", me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.
2. *Mbledhja e KKTU – e martë, 28.01.2025, ora 09:00 - 11:00*
   Pika 39. Leje Ndërtimi për objektin "Resort turistik në Gadishullin e Zvërnecit", Blloku Rezidencial "F1V2, F1V3, F1R6", me vendndodhje në Pishë Poro-Nartë, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.
3. *Mbledhja e KKT – e premte, 04.10.2024, ora 10:00 - 11:00*
   Pika 9. Leje Zhvillimi për objektin "Resort turistik", me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.

4. *Mbledhja e KKT – e mërkurë, 25.09.2024, ora 14:00 - 16:00*
   Pika 19. Leje Zhvillimi për objektin "Resort turistik", me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.
5. *Mbledhja e KKT – e mërkurë, 28.05.2025, ora 15:00 - 17:00*
   Pika 14. Leje Ndërtimi për objektin "Kompleks turistik me program hoteleri dhe shërbime, 11 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Turi M.Z.P." sh.p.k.
6. *Mbledhja e KKTU – e mërkurë, 25.06.2025, ora 13:00 - 15:00*
   Pika 21. Leje Ndërtimi për objektin "Arte Marea 1", kompleks turistik dhe shtëpi pushimesh, shërbime dhe hotel, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Green Investment" sh.p.k.
7. *Mbledhja e KKTU – e mërkurë, 23.07.2025, ora 11:30 - 13:30*
   Pika 26. Leje Zhvillimi për objektin "Kompleks turistik pranë fshatit Zvërnec", me vendndodhje në Bashkinë Vlorë; subjekt zhvillues: "Concord Investment" sh.p.k.
8. *Mbledhja e KKT – e martë, 09.07.2024, ora 16:00*
   Pika 18. Leje Zhvillimi për objektin "Kompleks turistik pranë fshatit Zvërnec", me vendndodhje në "Rruga e Pishave", Bashkia Vlorë; subjekt zhvillues: "Concord Investment" sh.p.k.

Për secilën nga pikat e mësipërme, kërkojmë:

A) Vendimin/aktin përfundimtar të KKT/KKTU, përfshirë numrin, datën, titullin e vendimit dhe çdo kusht/klauzolë të vendosur (nëse është miratuar) ose aktin e refuzimit/pezullimit (nëse është refuzuar/pezulluar).

B) Statusin aktual të dosjes (miratuar, refuzuar, pezulluar, kthyer për plotësim, në shqyrtim etj.), si dhe datën e statusit të fundit.

C) *Relacionin/raportin shoqërues të dosjes që i është paraqitur KKT/KKTU (materiali i përgatitur nga sekretariati/AKPT/strukturat përgjegjëse).*

D) Kërkesën zyrtare të subjektit zhvillues dhe dokumentet bazë të paraqitura në aplikim (formular aplikimi/kërkesë, lista e dokumenteve shoqëruese), në masën që janë pjesë e dosjes administrative.

E) Planvendosjen/koordinatat/hartat e vendndodhjes dhe kufijtë e zhvillimit (planimetria e sitit), si dhe çdo dokument të disponueshëm mbi pronësinë/parcelat e përfshira (nëse gjendet në dosje).

F) Projekt-idenë/masterplanin/planimetrinë kryesore (përfshirë parametrat kryesorë: sipërfaqe ndërtimi, numër i kateve, kapacitetet, funksionet), sipas dokumenteve që shoqërojnë vendimin.

G) Akte dhe opinione të institucioneve të konsultuara, përfshirë, por pa u kufizuar në: mendime/konfirmime paraprake, shkresa, aprovim/jo aprovim nga institucionet përgjegjëse për mjedisin, trashëgiminë kulturore, infrastrukturën, ujërat, zonat e mbrojtura etj. (sa herë që janë pjesë e dosjes).

H) VNM/VSM dhe dokumentacion mjedisor (nëse ka): vendim për VNM, raport VNM, konsultimet publike për VNM, vendim mjedisor, kushte mjedisore, ose shkresat që konfirmojnë se projekti nuk i nënshtrohet VNM.

I) *Procesverbalin e mbledhjes për pikat përkatëse (ose pjesën relevante të procesverbalit), si dhe çdo material prezantimi të depozituar për shqyrtim në mbledhje.*

J) *Çdo akt të mëvonshëm ndryshues/plotësues: ndryshim lejeje, shtesë kushtesh, zgjatje afatesh, transferim subjekti, ndryshim projekti ose vendim shfuqizues (nëse ekziston).*

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, regjistruar me nr. 628 prot., datë 26.02.2026, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me *e-mail*-in datë 02.03.2026, ka kthyer përgjigje duke sqaruar, ndër të tjera, se: *"...në lidhje me vendimmarrjet e kërkuara të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit nuk janë zbardhur ende, ndërkohë referuar nenit 3 "E drejta e informimit", pika 4, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (ligj të cilit ju i referoheni edhe në shkresën tuaj): "Informacioni publik, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjekteve, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji", si dhe nenit 17 "Kufizime", pika 1, shkronja "c", të cituar më lart, e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit, siç janë preventivat që ju kërkoni, Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk mund t'ju vërë në dispozicion të personave të tretë, mbështetur edhe në nenin 8 "Veprat", pika 1, shkronjat "e" dhe "g", të ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore; g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi.*

Gjithashtu, në vijim të përgjigjes së shkresës suaj, ju bëjmë me dije se referuar ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dokumentacioni që ju kërkoni duke përmendur dokumentacionin e pronësisë, si dhe kontratat e sipërmarrjes, nuk mund t'ju vendoset në dispozicion nga ana jonë, pasi përmbajnë të dhënat personale".

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me *e-mail*-in datë 04.03.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 628/1 prot., datë 04.03.2026, ka vijuar ankimin me pretendimin se përgjigjja e Autoritetit Publik nuk është e plotë, duke kërkuar informacionin për tre pika të kërkesës mbi vendimet e sipërcituara, konkretisht: *"G)* ***Akte dhe opinione të institucioneve të konsultuara****, përfshirë, por pa u kufizuar në: mendime/konfirmime paraprake, shkresa, aprovim/jo aprovim nga institucionet përgjegjëse për mjedisin, trashëgiminë kulturore, infrastrukturën, ujërat, zonat e mbrojtura etj. (sa herë që janë pjesë e dosjes); H)* ***VNM/VSM dhe dokumentacion*** *mjedisor (nëse ka): vendim për VNM, raport VNM, konsultimet publike për VNM, vendim mjedisor, kushte mjedisore ose shkresat që konfirmojnë se projekti nuk i nënshtrohet VNM; I)* ***Procesverbalin e mbledhjes për pikat përkatëse*** *(ose pjesën relevante të procesverbalit), si dhe çdo material prezantimi të depozituar për shqyrtim në mbledhje.*

Të tria këto janë dokumente që prodhohen nga institucionet dhe duhet t'i bashkëlidhen dosjes. Ato nuk mbrohen nga e drejta e autorit e të ngjashme, pasi janë dokumente që duhet të bëhen publike dhe mund të bëhen publike me kërkesë".

Pas vijimit të ankimit, Autoriteti Publik, me *e-mail*-in datë 17.03.2026, ka bërë me dije se *të gjitha aktet e VNM-ve, si dhe Deklaratave Mjedisore mund t'i aksesoni online në faqen zyrtare të AKM-së. Gjithashtu, në përfundim të procedurës administrative do t'ju vendosim në dispozicion Vendimin e KKT-së/KKTU-së, Hartën e Planvendosjes së Strukturave, si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë.*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me *e-mail*-in datë 17.03.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 628/2 prot., datë 17.03.2026, ka vijuar ankimin, duke u shprehur se kërkesa mbetet e papërmbushur dhe ka kërkuar vendosjen në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjes, akteve dhe opinioneve të institucioneve dhe dokumentacionit mjedisor.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me *e-mail*-in datë 19.03.2026, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 26.03.2026.

Autoriteti Publik, me *e-mail*-in datë 22.05.2026 dhe shkresën nr. 3887 prot., datë 22.05.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 628/5 prot., datë 25.05.2026, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar, ndër të tjera, se: *"...Në lidhje me vendimmarrjet e sipërcituara, ju bëjmë me dije se vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e subjektit zhvillues, institucioni jonë do të vijojë me procedurat e zbardhjes së vendimeve të sipërcituara, të cilat pas nënshkrimit nga kryetari i KKTU-së, ministrit të linjës, si dhe sekretarit të KKTU-së, do të mund t'i aksesoni në faqen zyrtare web të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit www.azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKT".*

Ritheksojmë se për vendimmarrjet të cilat nuk janë zbardhur ende, përfshirë projektin arkitektonik dhe hartat e planvendosjes së strukturave, mund t'ju vendosen në dispozicion vetëm pas zbardhjes së vendimit. Sqarojmë se, në referim të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ duhet të respektojë disa kërkesa të formës, si dhe në zbatim të nenit 100 të po këtij Kodi, akti administrativ i shkruar duhet të jetë i arsyetuar qartë, duke përmbajtur situatën faktike, si dhe bazën ligjore mbi të cilën mbështetet. Për sa kohë akti nuk është zbardhur dhe nuk përmban ende këto elemente thelbësore të formës dhe arsyetimit, ai nuk mund të konsiderohet një akt administrativ i formuar ligjërisht, i cili të mund t'iu vendoset në dispozicion.

Ju informojmë se procesverbalet e mbledhjeve, relacionet, mendimet teknike, shënimet administrative dhe çdo akt tjetër përgatitor i administruar gjatë shqyrtimit të çështjes përbëjnë dokumente të brendshme institucionale, të hartuara në kuadër të procedurës administrative dhe procesit të konsultimit e vendimmarrjes së autoritetit përkatës. Në

referim të parimeve të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dokumentacioni i brendshëm me karakter përgatitor dhe ndihmës administrativ nuk përbën akt administrativ përfundimtar dhe, për shkak të natyrës së tij të brendshme procedurale, nuk mund t'u vihet në dispozicion palëve të treta.

Në këtë kuptim, qëndrimi zyrtar dhe vullneti administrativ i institucionit materializohet vetëm në aktin administrativ përfundimtar të zbardhur dhe të miratuar nga organi kompetent, i cili përfaqëson përfundimin e një procedure të gjatë shqyrtimi administrativ, teknik dhe ligjor, të zhvilluar mbi bazën e analizës së dokumentacionit, verifikimeve përkatëse dhe vlerësimeve të kryera gjatë gjithë procesit vendimmarrës. Për rrjedhojë, vetë vendimi përfundimtar përbën aktin e vetëm zyrtar që prodhon pasoja juridike dhe pasqyron konkluzionin përfundimtar të autoritetit publik.

Gjithashtu, ju sqarojmë se, bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përfshirë VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", pajisja me Vendim për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) nuk përbën dokumentacion të detyrueshëm në fazën e miratimit të lejes së zhvillimit, pasi kjo leje ka karakter përcaktues të kushteve zhvillimore të pronës dhe nuk autorizon kryerjen e punimeve ndërtimore. Detyrimi për administrimin e dokumentacionit mjedisor vlerësohet në fazën e pajisjes me leje ndërtimi, në varësi të natyrës dhe kategorisë së zhvillimit të propozuar. Për projektin Arte Marea 1, lutemi gjeni bashkëlidhur Vendimin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) përkatës.

Në lidhje me kërkesën zyrtare të subjekteve zhvilluese ju sqarojmë se, të gjitha kërkesat për shqyrtimin e aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi kryhen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit (sistemi e-leje), referuar dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 43 "Kërkesat për leje ndërtimit" të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar. Në lidhje me sa më sipër, lutem gjeni bashkëlidhur formatet e aplikimit për secilin aplikim të cituar në shkresën tuaj".

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 08.06.2026, me pjesëmarrjen e palëve, të ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik, znj. Marjana Banaj, me detyrë koordinatore për të drejtën e informimit, dhe znj. Artemis Poshi, me detyrë përgjegjëse pranë Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik parashtruan argumentet e tyre, duke rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara

më sipër. Në përfundim të seancës dëgjimore, ankuesi i mbeti qëndrimit të tij për dhënien e informacionit, për dy pika të kërkesës mbi vendimet e marra, konkretisht aktet dhe opinionet e institucioneve të konsultuara, si dhe procesverbalin e mbledhjes për pikat përkatëse (ose pjesën relevante të procesverbalit). Ndërkohë, Autoritetit Publik iu la afati të rishikonin qëndrimin e mbajtur, brenda datës 10.06.2026.

Në tejkalim të afatit të vendosur nga Komisioneri, Autoriteti Publik, me *e-mail*-in datë 23.06.2026, ka kthyer përgjigje, duke bërë me dije se: *"Procesverbalet e mbledhjeve të KKTU-së nuk përbëjnë akte administrative në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi ato nuk krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë të drejta dhe detyrime për subjektet e interesuara. Aktet që prodhojnë pasoja juridike janë vendimet përfundimtare të KKTU-së, të cilat miratohen dhe publikohen sipas legjislacionit në fuqi, në faqen zyrtare të AZHT-së, në rubrikën "Vendime KKT".*

Për sa i përket mendimeve të institucioneve të përfshira në procedurën e shqyrtimit, ju bëjmë me dije se këto dokumente janë pjesë e dosjes administrative në proces e, për rrjedhojë, ato do të mund të vihen në dispozicion vetëm pas përfundimit të procedurës administrative përkatëse, zbardhjes së vendimmarrjes së KKTU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se informacionin mbi lejet e shqyrtuara nga KKTU mund ta aksesoni në rubrikën "Njoftimet e fundit", në faqen web www.azht.gov.al, në të cilën do të gjeni rendet e ditës për çdo mbledhje, duke garantuar transparencën mbi çështjet e trajtuara".

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, me *e-mail*-in datë 23.06.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 628/9 prot., datë 24.06.2026, ka vijuar ankimin për aktet dhe opinionet e institucioneve të konsultuara dhe procesverbalet e KKTU-së.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në kuptim të nenit 2, pika 1, shkronja "a", të LDI-së, Agjencia e Zhvillimit të Territorit është autoritet publik dhe, si i tillë, i nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë ligj.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike".*

Në përputhje me objektin dhe qëllimin e mësipërm, LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: *1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë* dhe *2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.* Në kategorinë e parë përfshihen ato

kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti. Rasti konkret, objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione, për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI-së.

Lidhur me qëndrimin e Autoritetit Publik se mendimet e institucioneve të përfshira në procedurën e shqyrtimit janë pjesë e një dosjeje administrative në proces dhe mund të vihen në dispozicion vetëm pas përfundimit të procedurës dhe zbardhjes së vendimmarrjes së KKTU-së, Komisioneri vlerëson se ky qëndrim nuk gjen mbështetje në LDI.

Legjislacioni që rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike është LDI, i cili parashikon bërjen publike të informacionit që disponohet nga këta të fundit. Në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, parashikohet se: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".*

Sa më sipër, mendimet e institucioneve të përfshira në procedurën e shqyrtimit përbëjnë informacion publik në kuptim të nenit 2, pika 2, të LDI-së. Fakti që këto dokumente janë prodhuar nga institucione të tjera, nuk ndryshon natyrën e tyre si informacion publik, për sa kohë që ato administrohen nga AZHT në kuadër të shqyrtimit të kërkesave nga KKTU. Në çdo rast, edhe sikur i njëjti informacion të mos kërkohej pranë AZHT-së, por pranë institucionit që ka dhënë mendimin, ky i fundit, qoftë si institucioni që e ka prodhuar dhe qoftë si ai që e ka në administrim atë, është i detyruar t'ia vendosë në dispozicion publikut. Si rrjedhojë, aksesi në këtë informacion mund të kufizohet vetëm nëse Autoriteti Publik provon ekzistencën e një prej rasteve të parashikuara në nenin 17 të LDI-së dhe plotësimin e kushteve përkatëse për kufizimin e aksesit.

Nga ana tjetër, është zhvilluar procesi i marrjes dhe shqyrtimit të mendimeve të paraqitura nga institucionet mendimdhënëse dhe vendimmarrja mbi pranimin ose refuzimin e tyre ka përfunduar me marrjen e vendimit nga KKTU, siç referohet në përgjigjet e Autoritetit Publik. Në këto kushte, vënia në dispozicion e mendimeve të dhëna nga institucionet mendimdhënëse nuk cenon asnjë nga interesat e parashikuar nga neni 17 i LDI-së. Procesi i konfirmimit apo zbardhjes së vendimeve nga AZHT, sa i takon mendimeve, lidhet vetëm me referimin e mendimeve të administruara ose vlerësimin që i është bërë secilit prej tyre, por në asnjë rast nuk sjell pasoja mbi vendimin e marrë tashmë nga KKTU.

Gjithashtu konstatohet se Autoriteti Publik në asnjë moment nuk ka argumentuar apo cituar se në cilën pikë të nenit 17 të LDI-së e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen i cili parashikon mundësinë e kufizimit të së drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Ndërkohë, nëse mendimi i dhënë përmban elemente/informacione që cenojnë ndonjë nga interesat e parashikuar në nenin 17 të LDI-së, në frymën e pikës 6 të tij, sipas të cilit: "*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*", AZHT duhet të vlerësojë kufizimin e pjesëve të cilat, sipas gjykimit të saj, i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuesit pjesën tjetër të informacionit.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/ dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se *procesverbalet e mbledhjeve të KKTU-së nuk përbëjnë akte administrative në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi ato nuk krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë të drejta dhe detyrime për subjektet e interesuara. Aktet që prodhojnë pasoja juridike janë vendimet përfundimtare të KKTU-së, të cilat miratohen dhe publikohen sipas legjislacionit në fuqi, në faqen zyrtare të AZHT-së në rubrikën "Vendime KKT"*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Komisioneri vlerëson se fakti që ky dokument nuk përbën akt administrativ përfundimtar nuk e përjashton atë, në vetvete, nga koncepti i "informacionit publik". Në kuptim të nenit 2, pika 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, procesverbali, për sa kohë është informacion i regjistruar, i prodhuar ose i administruar nga autoriteti publik, përbën në parim informacion publik.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioneri vlerëson se aksesueshmëria e procesverbalit duhet të shqyrtohet në kuadër të LDI-së dhe, në veçanti, të përkufizimit të informacionit publik të parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

Sa më sipër, LDI nuk garanton të drejtën e informimit vetëm për atë kategori të informacionit publik që përbën akt administrativ në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative. Përkundrazi, LDI përmban një përkufizim të gjerë të konceptit të informacionit publik, i cili përfshin çdo të dhënë të regjistruar, pavarësisht formës ose formatit të saj. Në këtë kuptim, krahas vendimeve apo akteve administrative, informacion publik mund të përbëjnë edhe akte normative, korrespondenca administrative, procesverbale, dokumente politikash, analiza, statistika etj., si dhe informacioni i regjistruar ose i ruajtur në formë elektronike, audiovizuale apo në formate të tjera.

Përkufizimi i sipërcituar nuk bën asnjë dallim as sa i përket destinacionit apo përdorimit të informacionit publik, qoftë ai për përdorim të brendshëm ose jo. Prandaj, si akti administrativ që i njoftohet të tretëve, akti që është i detyrueshëm për botim/publikim, apo akti i cili normalisht nuk publikohet në mënyrë proaktive nga institucioni, përveç rasteve kur kërkohet të merret përmes një kërkese për informacion, përbën informacion

publik. Si pasojë, edhe procesverbali, si një prej kategorive të informacionit që prodhon apo administron një institucion, përbën informacion publik, sipas LDI-së.

Sa më lart, nuk vihet në diskutim fakti se procesverbali i KKTU-së, për shkak të përmbajtjes së tij dhe se mbahet në kuadër të ushtrimit të funksionit publik, përbën informacion publik në kuptim të nenit 2, pika 2, të LDI-së. Çështja që kërkon zgjidhje lidhet me fazën procedurale në të cilën ai ndodhet dhe me faktin nëse, në momentin e kërkesës, vendimmarrja që ai pasqyron është formalizuar ose jo përfundimisht. Prandaj, vlerësimi i aksesit në këtë dokument duhet të bëhet duke marrë në konsideratë natyrën dhe funksionin e tij në kuadër të procedurës konkrete të vendimmarrjes së organit kolegjial, si dhe fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë.

Fillimisht, sillet në vëmendje se sipas pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, parashikohet se: *"13. "Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU)" është organ kolegjial që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri".* Sipas pikës 5 të vendimit nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, parashikohet se: *"5. Sekretariati teknik i KKTU-së zbardh vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar. Vendimet nënshkruhen edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretarit të KKTU-së. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë. Në rastin e zbardhjes së vendimeve, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, sekretariati teknik koordinon veprimet me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet për dhënie lejeje apo autorizimi, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, nënshkruhen edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe, kur është rasti, edhe nga sekretari i KKTU-së, hyjnë në fuqi menjëherë".*

Ndërkohë, sipas pikës 5 të nenit 98 të KPA-së parashikohet se: *"5. Aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike".* Nga ana tjetër, ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", e rregullon procesverbalin në nenin 16 të tij, ku parashikohet se: *"1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve".*

Në vijim të hetimit administrativ, rezulton se janë kërkuar procesverbalet për disa vendime për të cilat, sipas shpjegimit të dhënë nga AZHT, vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e subjektit zhvillues, institucioni do të vijojë me procedurat e zbardhjes së vendimeve. Pra, KKTU ka shprehur vullnetin vendimmarrës në mbledhje, por procedura e formalizimit të këtij vullneti në aktin administrativ përfundimtar ende nuk ka përfunduar, pasi hapat që ndiqen për hyrjen në fuqi të vendimeve përkatëse rezultojnë se janë:

1. Plotësimi i të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e subjektit zhvillues;
2. Zbardhja e vendimit nga sekretariati teknik i KKTU-së, pra AZHT;
3. Nënshkrimi nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

Sipas dispozitave të sipërcituara, AZHT zbardh vendimet e KKTU-së dhe ua përcjell për nënshkrim funksionarëve përkatës, ndërsa vendimet hyjnë në fuqi vetëm pas nënshkrimit të tyre. Për rrjedhojë, fakti që KKTU ka marrë një vendim në mbledhje, nuk mund të barazohet automatikisht me përfundimin e procesit të formalizimit të aktit administrativ.

Sa më sipër, rezulton se ka një lidhje të pandashme midis aktit të një organi kolegjial dhe procesverbalit të mbledhjes së tij. Për më tepër, procesverbali pasqyron diskutimet, qëndrimet, vendimmarrjen dhe rezultatin e votimit të anëtarëve të KKTU-së dhe, për rrjedhojë, përbën një dokument themelor për formalizimin dhe zbardhjen e vendimit të marrë. Në rrethanat konkrete, ai është dokument funksionalisht dhe juridikisht i lidhur me procesin e formalizimit të një vendimmarrjeje kolegjiale, që ende nuk ka përfunduar në formën e kërkuar nga legjislacioni. Pikërisht për shkak të faktit se procesverbali përmban të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me aktin, ai ndjek rrjedhën e vendimit të KKTU-së dhe, si pasojë, nuk mund të vendoset në dispozicion pa u zbardhur ky vendim. Në këto kushte, vënia në dispozicion e procesverbalit përpara përfundimit të procesit të formalizimit të vendimmarrjes do të ekspozonte elemente të diskutimit dhe të formimit të vullnetit të organit kolegjial përpara se ky vullnet të jetë konsoliduar dhe formalizuar sipas procedurës së posaçme.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së, parashikohet se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së z. , gazetar pranë "BIRN Albania", me nr. 628 prot., datë 26.02.2026, vijuar me nr. 628/9 prot., datë 24.06.2026, ndaj Autoritetit Publik "Agjencia e Zhvillimit të Territorit", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 30.01.2026. për pikën: *G) Akte dhe opinione të institucioneve të konsultuara, përfshirë, por pa u kufizuar në: mendime/konfirmime paraprake, shkresa, aprovim/jo aprovim nga institucionet përgjegjëse për mjedisin, trashëgiminë kulturore, infrastrukturën, ujërat, zonat e mbrojtura etj. (sa herë që janë pjesë e dosjes)*, brenda datës 15.09.2026.
3. Rrëzimin e ankesës për informacionin/dokumentacionin e kërkuar në pikën *I) Procesverbalin e mbledhjes për pikat përkatëse (ose pjesën relevante të procesverbalit)*, brenda datës 15.09.2026.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 04.09.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi